



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Maj, 2016

Agjendë e re e takimeve me anëtarësinë nëpër komunat e Kosovës
Bashkëpunim me GIZ-in në shërbim të ngritjes së cilësisë në arsim



Ka nisur SBASHK-u agjendën e re të takimeve me anëtarësinë nëpër komunat e Kosovës. Është ky aktivitet në bashkëpunim me GIZ dhe ka për qëllim që të nxis mësimdhënësit që të jenë sa më aktivë në hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës. Takimet janë zhvilluar në Prishtinë, Kastriot (Obiliq), Podujevë, Deçan dhe Pejë. Në hapje të agjendës së vizitave nëpër komuna (faqe 5)

Punëtori strategjike e organizuar Nga ILO dhe ITUC

Paraqitje e shkëlqyer e përfaqësuesve të SBASHK-ut



Me qëllim që të krijojnë parakushte për ndryshime të dukshme në funksionimin dhe veprimin sindikal... (faqe 6)

SBASHK-u vazhdon me shërbimet për anëtarësinë

Nëse mendoni se u janë shkelur të drejtat tuaja drejtojeni juristit të SBASHK-ut

Edhe një kërkesë e anëtarësisë së SBASHK-ut është realizuar. Ata vazhdimisht kanë kërkuar që(faqe 9)

Inervistë me kryetarin e Kuvendit të Arsimit të Mesëm të Kosovës, z. Besnik Krasniqi

SBASHK-u është shumë unik dhe i vendosur që të mbrojë me çdo kusht të drejtat e punëtorëve të arsimit

Edhe të punëusarit e arsimit të mesëm të Kosovës janë anëtarë të SBASHK-ut. Ata kanë Kuvendin etyre (faqe 3)

SBASHK-u fillon takimet me kryetarë të Grupeve parlamentare

Kryetari i Grupit parlamentar të PDK-së, z. Grabovci premtoi përkrahje të plotë



Në përpjekje për të realizuar me dialog kërkesat e anëtarësisë kryetari i ... (faqe 8)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Po përfundojmë edhe një vit shkollor



Qershori shënon kohën kur të punuarit në arsimin e Kosovës përmbyllin

dhe një betejë të diturisë. Edhe ky vit shkollor kishte momentet e bukura, që ishin shumë, por kishte aty e këtu edhe momente me plot sfida. Shumica e mësimeve vazhduan me përkushtimin dhe kur bëjnë vlerësimin e arritjeve mund të shkojnë të qetë në pushime.

Një moment emocional gjatë këtij viti ishte atmosfera festive e plot emocione në kremtim të 7 Marsit. SBASHK-u bashkoi në një vend të 557 të pensionuarit nga marsi i vitit të kaluar e deri në marsin e vitit 2016. U takuan këta pishtarë të arsimit

dhe bashkëbiseduan gjatë për moshën e rinisë e të studimeve. Kujtuan kohën e vështirë të okupimit dhe nuk harruan as momentin prekës të ndarjen me nxënës e kolegë nga arsyeja e pensionimit.

Qershori na zuri me shumë arritje, por analizat tregojnë se na ka mbetur ende punë për të bëra. Tani SBASHK-u po angazhohet në realizimin e kërkesave, por edhe në përgatitjen sa më të mirë të pushimeve për 420 anëtarë nga e tërë Kosova. I përgëzoj gjithë të punësuarit në arsim për punën e angazhimet, ndërsa të 420 anëtarëve që shkollat e tyre i kanë zgjedhur që të jenë pushues në bregdetin shqiptar ju dëshiroj pushime të mrekullueshme.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Inervistë me kryetarin e Kuvendit të Arsimit të Mesëm të Kosovës, z. Besnik Krasniqi

SBASHK-u është shumë unik dhe i vendosur që të mbrojë me çdo kusht të drejtat e punëtorëve të arsimit



Edhe të punëusarit e arsimit të mesëm të Kosovës janë anëtarë të SBASHK-ut. Ata kanë Kuvendin etyre, kryesinë dhe kryetarin që i përfaqëson në kryesinë qendrore të SBASHK-ut. Është ky Besnik Krasniqi. Ai është mësimdhënës i respektuar nga nxënësit

dhe veprimtar i dalluar sindikal. E punon me përkushtim lëndën e tij dhe për lexuesit po tregojmë se di përmendesh një numër shumë të madh të poezive të autorëve shqiptar e botëror. . Ato i reciton bukur dhe vargjet e tyre i ndërlidh për të forcuar argumentet nëpër situata. Në vitin shkollor 2008-2009 për nder të” 7 Marsit” Ditës së Mësuesit u shpërbleve me mirënjohjen Arsimitar i dalluar për shkolla të mesme nga Ministri i Arsimit Z. Enver Hoxhaj. Për ju po sjellim intervistën me të.

Arsimimi sot :

Kush është Besnik Krasniqi?

Besniku:

U linda më 17.09.1959 në fshatin Hoçë e Qytetit-Prizren. Fëmijërinë e kalova në fshat, ku dhe kreu shkollën tetëvjeçare. Te mesmen, Gjinnazin e kreu në Prizren, ndërsa Fakultetin Filologjik, Dega: Letërsi e Gjuhë Shqipe në Prishtinë. Në vitin 1982 punova si mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollën tetëvjeçare “Muharrem Bekteshi” të Hoçës. Në vitin 1983, u punësova në Gjinnazin “Gjon Buzuku,” në të cilën shkollë punova deri më 2010. Nga 2010- 2013 isha drejtor në Q.B.” Nënë Tereza”-Prizren. Ndërsa nga 2014 u ktheva përsëri në Gjinnazin “Gjon Buzuku” ku punoj edhe tani. Kam të kryer shumë trajnime, që

më kanë ndihmuar edhe në ngritjen time profesionale dhe në punën me nxënës.Do veçoj atë të MKLSH-së, ku jam edhe trajner. Për punën time të suksesshme me nxënës, në vitin shkollor 2008-2009 për nder të” 7 Marsit” Ditës së Mësuesit u shpërbleva me mirënjohjen Arsimitar i dalluar për shkolla të mesme nga Ministri i Arsimit Z. Enver Hoxhaj. Këtë mirënjohje e konsiderova si një obligim shtesë për të vazhduar me një përkushtim më të shtuar në procesin e punës sime me nxënës.

Arsimimi sot :

Fillimet tua në SBASHK?

Besniku:

Anëtar i SBASHK-ut jam që nga themelimi. Në vitin 2000 jam zgjedh kryetar i sindikatës në Gjinnazin “Gjon Buzuku,”ndërsa më 2001 jam zgjedh koordinator për Regjionin e Prizrenit. Më pas në Kuvendin zgjedhor u zgjedha kryetar për AM të Kosovës dhe tani ushtroj këtë funksion edhe në mandatin e dytë. Kjo detyrë ma mundëso që të jem edhe anëtar i kryesisë së SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Si e shihni SBASHK-un sot. Angazhimi juaj si kryetar?

Besniku:

SBASHK-u sot ka krijuar një fizionomi të re. Është shumë unik dhe i vendosur që të mbrojë me çdo kusht të drejtat e punëtorëve të arsimit. Në këtë drejtim po punohet shumë, duke filluar nga kryetari i SBASHK-ut Z. Raman Jashari dhe kryesia, por edhe Këshilli Drejtues. Asgjë nuk vendoset pa u marr mendimi nga baza. D.m.th. ka një koordinim punësh,prandaj edhe rezultatet nuk na mungojnë. Edhe angazhimi im është po në këtë frymë. Takohem me kryetarë shoqatash

sindikale të shkollave nëpër komuna të ndryshme të Kosovës. Sqarojmë për punën tanë, angazhimin dhe përpjekjet për arritjen e qëllimeve. Gjithnjë jam aty ku e kërkon nevoja. Këtë e bëj pa asnjë përtesë.

Arsimimi sot:

Jeni i respektuar nga të gjithë në SBASHK, si e keni arritur këtë?

Besniku:

Është shumë vështirë të fitosh respektin e të gjithëve. Asgjë nuk është absolute. Unë jam shumë i lumtur që punën time e konsiderojnë të vlefshme shokët dhe bashkëpunëtorët e mi. Jam përpjekur të jam i sinqertë në punë, në takime të ndryshme, ku në fokus ishin të drejtat e punëtorëve të arsimit, e si duket kjo ka rënë në sy të anëtarësisë dhe po them edhe për këtë gëzoj respektin e tyre. Por, pa e harruar edhe aktivitetin dhe punën time shumëvjeçare që kam bërë në SBASHK. Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë ata që e çmojnë punën time dhe të gjithë ata që më respektojnë.

Arsimimi sot:

Cilat arritje të SBASHK-ut do t'i veçoni dhe çka tutje?

Besniku:

Është shumë vështirë të listohen të arriturat e SBASHK-ur gjatë një intervistë. SBASHK-u ka bërë shumë punë të vlefshme për anëtarët si : Kontrata Kolektive, arritja e shumë marrëveshjeve në Kosovë dhe jashtë saj në dobi të mësimdhënësve. Shumë seminare, trajnime konferenca janë mbajtur me anëtarësinë. Do veçoja ECDL dhe Dialogun Social që e kanë përfshi pjesën dërmuese të anëtarësisë, në gjithë Kosovën.

Me gjithë këto të arritura ne nuk do të ndalemi. Do vazhdojmë me përkushtim të shtuar që të japim gjithçka që mundemi për të përfutur punëtorët e arsimit. Do trokasim në çdo derë të hapur e të mbyllur, për të drejtat e anëtarëve të SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Porosia juaj për anëtarët e SBASHK-ut?

Besniku:

Ruajeni SBASHK-un si shtëpinë tuaj. Të jeni sa më unik dhe të bashkuar. Të mos gënjeheni nga njerëz që e kundërshtojnë SBASHK-un, për shkak të interesave të ngushta dhe individuale. T'u japim përgjigjen e merituar, duke u anëtarësuar edhe ato pak shkolla. që na kanë mbetur dhe të tregojmë së SBASHK-u, jo vetëm që ka qenë, por edhe do të jetë shtëpia jonë e përbashkët.

Gjatë muajit

Agjendë e re e takimeve me anëtarësinë nëpër komunat e Kosovës

Bashkëpunim me GIZ-in në shërbim të ngritjes së cilësisë në arsim

Ka nisur SBASHK-u agjendën e re të takimeve me anëtarësinë nëpër komunat e Kosovës. Është ky aktivitet në bashkëpunim me GIZ dhe ka për qëllim që të nxis mësimdhënësit që të jenë sa më aktivë në hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës. Takimet janë zhvilluar në Prishtinë, Kastriot (Obiliq), Podujevë, Deçan dhe Pejë.



Në hapje të agjendës së vizitave nëpër komuna në takimin me mësimdhënës nga Prishtina është zhvilluar një bashkëbisedë e singertë mes anëtarësisë dhe përfaqësuesve të SBASHK-ut. Kryetari i Kuvendit të SAF e SAM të Prishtinës, z. Ahmet Pllana ka bërë një analizë të aktivitetit sindikal në këtë komunë. Pas kësaj nënkryetari Lutfi Mani dhe përgjegjësi për financa e administratë, Ymer Ymeri kanë shpalosur pjesë nga angazhimi i përbashkët me GIZ dhe kanë folur për detyrat e mësimdhënësve të Kosovës lidhur me hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës. Ata kanë shpërndarë për pjesëmarrësit dhe shkollat e tyre edhe posterë dhe fletëpalosje që sqarojnë konkretisht çështje nga tema e kësaj bashkëbisede. Në pjesën e dytë të takimit me përfaqësues sindikalë nga shkollat e Prishtinës është bashkëbiseduar për arritjet, sfidat dhe angazhimet e SBASHK-ut duke filluar nga shoqata sindikale e deri në nivelin qendror.



Takime të suksesshme janë zhvilluar edhe në komunën e Deçanit e atë të Pejës. Në Deçan hapjen e takimit të ambientet e Asamblesë Komunale e ka bërë kryetari i Kuvendit të SAF e SAM të kësaj komune, Avdulla Lata. Ai ka kujtuar disa nga aktivitetet e zhvilluara në këtë komunë. Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka folur për çështje nga tema kyçe lidhur me rolin e mësimdhënësve në hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës dhe ka lavdëruar bashkëpunimin me GIZ. Në pjesën e dytë të takimit ai u është përgjigjur shumë pyetjeve që kishin të bënin me kresat konkrete të anëtarësisë dhe për aktualitetin e angazhimeve të SBASHK.



Në Pejë takimi është zhvilluar në Shkollën “Xhemajl Kada”. Fillimisht kryetarin e SBASHK-ut dhe anëtarët tjerë të delegacionit i ka takuar drejtori i këtij institucioni të suksesshëm arsimor, z. Nimon Alija, i cili ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet e singerta dhe për arritjet. Kryetari i Kuvendit të SAF e SAM të Pejës, Isuf Lajçi i ndihmuar nga kryetari i

shoqatës sindikale të shkollës mikpritëse, z. Avdulla Bujupi . Në këtë takim kryetari i SBASHK-ut është shoqëruar nga nënkryetari Lutfi Mani e përgjegjësi për financa e administratë, Ymer Ymeri.



Kryetari i Kuvendit të SAF e SAM të Pejës, Isuf Lajçi ka kujtuar aktivitetet sindikale në këtë komunë, por edhe në nivelin qendror. Pas kësaj kryetari Jasharaj i ndihmuar nga z. Mani e z. Ymeri kanë shtjelluar momente të angazhimeve lidhur me temën kyçe e pastaj janë përgjigjur edhe në pyetjet e shumta të pjesëmarrësve lidhur me angazhimet konkrete të SBASHK-ut. Pjesëmarrësit kanë dhënë edhe ide të reja lidhur me aktivitetet sindikale.



Një atmosferë e sinqertë pune ishte edhe në takimet me anëtarësinë në Kastriot (Obliq) dhe në Besianë (Podujevë). Edhe në këto takime kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM të këtyre komunave , z. Kadri Thaçi dhe z. Fadil Halimi kanë kujtuar aktivitetet e zhvilluara sindikale në komunat e tyre. Në Kastriot është vlerësuar se SBASHK-u është unik dhe se anëtarësia ka shtuar dukshëm besimin në sindikatën e tyre. Në Podujevë është thënë se duhet zhvilluar ende aktivitete e duhet bërë angazhime për të vizituar çdo shkollë dhe për të informuar nga afër mësimdhënësit për aktivitetet dhe arritjet e shumta të SBASHK-ut.



Agjenda do të vazhdojë edhe në komunat tjera të Kosovës.

Punëtori strategjike e organizuar Nga ILO dhe ITUC

Paraqitje e shkëlqyer e përfaqësuesve të SBASHK-ut

Me qëllim që të krijojnë parakushte për ndryshime të dukshme në funksionimin dhe veprimin sindikal të BSPK-së, Përfaqësuesit e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) Grigor Gradev dhe Lindita Boshtrakaj dhe përfaqësuesi i lartë i ITUC Jap Vienen kanë organizuar një punëtori strategjike me përfaqësues të

BSPK-së dhe me përfaqësues të federatave të forta e që nuk janë pjesë e kësaj Konfederate.

Përfaqësuesja e ILO-s për Kosovën, znj. Lindita Boshtrakaj ka përshëndetur pjesëmarrësit duke falënderuar në vazhdim të fjalës së saj zotërinjtë

Gradev e Vienen për angazhimin në të kaluarën dhe për kontributin e tyre në forcimin e sindikalizmit në Kosovë e Ballkan. Ajo këtë punëtori e ka vlerësuar si të rëndësishme në përpjekje që të krijohen parakushtet për ndryshime pozitive në BSPK.



Në pjesën e parë të këtij takimi dyditor, përfaqësuesit e lartë të ILO dhe ETUC kanë prezantuar para pjesëmarrësve çështje nga politika e integritetit në BE dhe dimensionin social i saj, nga perspektivat e ILO-s dhe BE-së e pastaj janë ndalur edehe të aktualiteti sindikal në Kosovë, gjegjësisht për problemet e shumta në BSPK. Vienen duke folur në emër të konfederatave sindikale Evropiane është shprehur se dialogu social në Kosovë po zhvillohet me vështirësi dhe ai pastaj ka apeluar që federata e forta, pa pasur nevojë të tregojnë për arsyet e ditura pse nuk janë pjesë e BSPK-së të prezantojnë pozicionet e tyre dhe të tregojnë për perspektivat e angazhimeve sindikale. . Dita e parë është shënuar edhe me një bashkëbisedë që në momente fitonte në dinamikë dhe krijonte edhe situata pak më të nxehta, por e gjitha bëhej në frymën e dialogut sindikal. Kryetari i SBASHK-ut, Përfaqësuesit e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe Ymer Ymeri kanë bërë diskutime të fuqishme duke treguar angazhimet dhe unitetin e shkëlqyer të SBASHK-ut. Në ditën e dytë të këtij aktiviteti ka ardhur radha e paraqitjeve të federatave të forta të cilat kanë prezantuar pozicionet e tyre karshi BSPK-së dhe mundësisë që federatat të përafrojnë bashkëpunimin dhe të krijojnë një zë më të fuqishëm e unik sindikal. Duke folur në emër të SBASHK-ut,

kryetari Jasharaj ka kujtuar momente e fakte të veçanta :

“SBASHK-u është Federata e vetme sindikale që përfaqëson të punësuarit në arsimin e Kosovës nga çerdhet e deri në Universitete ,

Ka përvojë 26 vjeçare të aktiviteteve në mbrojtjen e kresave të anëtarësisë,

U themelua në kushte të vështira dhe arriti të mobilizojë gjithë të punësuarit në arsim për mbrojtjen e arsimit dhe kulturës sonë në vitet e okupimit,

Është anëtare e Internacionales Botërore të Arsimit (EI) që nga viti 1996,

Në vitet e para të pasluftës falë ndihmës së madhe të sindikatave simotra nga Evropa dhe EI-së ka marrë pjesë aktive në nimat për një arsim sa më cilësor dhe në shërimin e plagëve të luftës, duke marrë pjesë në renovimin e ndërtimin e shkollave, në përkrahjen materiale e profesionale të mësimit dhe në aktivitete të tjera,

Merr pjesë aktive kudo të diskutohet e vendoset për arsimin, Organizon punëtori për ngritje sindikale, por edhe takime në shërbim të ngritjes së cilësisë dhe krijimin e kushteve edhe më të mira të punës,

Po arrin të realizoj hap pas hapi kërkesat e e anëtarësisë, Numri i anëtarëve në SBASHK-u shtohet vazhdimisht dhe tani kemi arritur në gati 21.000 anëtarë,

Kemi arritur 120 marrëveshje për zbritje çmimesh me biznese për shërbimet e tyre”, ka shpjeguar Jasharaj.

Ai pastaj ka treguar për pozicionin e SBASHK-ut në realitetin ekzistues duke veçuar këto qëndrime:

“Federatat (degët) të prezantojnë shënim e të sakta lidhur me anëtarësinë reale ,

Të organizohet Kongresi i BSPK-së me të gjithë pa kushtëzime dhe duke u bazuar në numrin real të degëve,

BSPK-ja para Kongresit të bëjë një hap të vullnetit të mirë duke mundësuar pjesëmarrjen në KES të një përfaqësuesi të SBASHK-ut dhe një përfaqësuesi të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë,

Të punohet në analizimin dhe në ndryshimet e Statutit të BSPK-së që ia të jetë në fundin të angazhimit dhe forcimit të zërit sindikal ,

Të respektohet fuqia e federatave në krijimin e organeve të BSPK-së dhe në vendimmarrje,

Të ndërrohet mënyra e kuotizimit, gjegjësisht e obligimit të Federatave ndaj BSPK-së. Të shkohet me anëtarësi fikse, që do të jepej në fillim të çdo viti.

Të krijohet një strategji e punës dhe e aktivitetit , që do të ishte e pranueshme nga të gjitha federatat”.

Pas tri javësh do të mbahet takimi i radhës me gjithë pjesëmarrësit nga ky takim.

SBASHK-u fillon takimet me kryetarë të Grupeve parlamentare

Kryetari i Grupit parlamentar të PDK-së, z. Grabovci premtoi përkrahje të plotë

Në përpjekje për të realizuar me dialog kërkesat e anëtarësisë kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i shoqëruar nga përgjegjësi për financa dhe administratë, Ymer Ymeri kanë nisur realizimin e agjendës së takimeve me kryetarët e grupeve parlamentare të subjekteve politike që janë në përbërje të Parlamentit të Kosovës. Ata sot janë takuar me kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Adem Grabovci me të cilin kanë biseduar për kërkesat e SBASHK-ut lidhur me

Projektligjin për Statusin e Punëtorëve të Arsimit Shqip në Republikën e Kosovës nga viti 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99. Po ashtu ky delegacion i SBASHK-ut ka kërkuar përkrahje e z. Grabovcit dhe



Grupit parlamentar të PDK-së që angazhohen që me rastin e plotësim-ndryshimit të Ligjit të Punës, neni 25 i këtij propozim-ndryshimi e që ka të bëjë me nenin 67 të Ligjit aktual të Punës të mundësojë, që jo vetëm mësuesit e nivelit të parë (nga klasa e parë e deri në klasën e pestë), por të gjithë të punësuarit në Arsimin Parauniversitar, që kanë nisur vitin shkollor, të mos largohen nga vendi i punës për arsye të ardhjes së

datës së pensionimit, por ta vazhdojnë atë deri në përfundim të vitit arsimor.

Delegacioni i SBASHK-ut ka sqaruar se në këtë mënyrë nuk do të krijoheshin zbrastimi në procesin mësues dhe se dy pagat për muaj e verës mësuesi që po pensionohet do t'i merrte dhe kështu do të plotësohej deri diku edhe kërkesa për tri pagat me rastin e pensionimit. Kryetari i Grupit parlamentar të PDK-së, z. Adem Grabovci i ka thënë përfaqësuesve

të SBASHK-ut se këto kërkesa dhe gjithë të tjerat që janë në harmoni me interesin e arsimit dhe në harmoni me mundësitë që ka shteti do ta kenë përkrahjen e plotë të tij dhe Grupit Parlamentar të PDK-së.

SBASHK-u do të vazhdojë me këtë agjendë takimesh për t'u takuar me kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Ismet Beqiri, të cilit i janë drejtuar me kërkesën për një takim për tema të njëjta. SBASHK-u do të takohet edhe me përfaqësues të tjerë të institucioneve e subjekteve politike për të kërkuar mbështetjen e tyre në Parlament lidhur me kërkesat aktuale të anëtarësisë.

SBASHK-u vazhdon me shërbimet për anëtarësinë

Nëse mendoni se u janë shkelur të drejtat tuaja drejtoju juristit të SBASHK-ut

Edhe një kërkesë e anëtarësisë së SBASHK-ut është realizuar. Ata vazhdimisht kanë kërkuar që një person profesional të ballafaqohet me ankesat e tyre lidhur me shkeljet e hetuara të të drejtave të tyre. Këshilli Drejtues i SBASHK-ut duke u angazhuar që të jetë pranë kërkesave të anëtarësisë ka obliguar kryetarin e SBASHK-ut dhe kryesinë që të shpallin konkurs dhe të angazhojnë një person të përgatitur për çështje juridike. Konkursi ishte shpallur bazuar në të gjitha kërkesat sipas ligjeve ekzistuese dhe paneli intervistues pas një pune të përkushtuar e transparente



i ka propozuar kryetarin të SBASHK-ut kandidatin , që dëshmoi njohuri më të larta. Kështu nga qershori i këtij viti të gjithë anëtarët e SBASHK-ut që mendojnë se u është shkelur cila do e drejtë që lidhet me punën dhe me çështje tjera janë të lirë t'i drejtohen juristit në adresat tona elektronike : sbashk2004@yahoo.com dhe info@sbashk-rks.org duke cekur se shkresa ka të bëjë me juristin.

Juristi do të analizojë shkresën dhe në afatin më të shkurtër të mundur do të vazhdojë proceduar dhe komunikimin me ju. Mos hezitoni në angazhimet për mbrojtjen e drejtave tuaja. Keni mbështetjen e vazhdueshme të SBASHK-ut.

Edhe një aktivitet me vlerë i SBASHK-ut

Prezantim i shkëlqyer i delegacionit të SBASHK në tryezën për ndryshimet në Ligjin për KES

Koordinatori i Grupit të BE-së për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me atë të Evropës, z. Bohuslav Pokorny kishte vizituar para pak ditësh selinë e SBASHK-ut dhe ka zhvilluar një takim shumë miqësor me kryetarin Rrahman Jasharaj dhe përgjegjësin për financa e administratë , Ymer Ymeri. Pokorny ka shprehur lëvdata për punën dhe përkushtimin e SBASHK-ut dhe ka falënderuar kryetarin Jasharaj për mikpritjen.



Ai pastaj nga përfaqësuesit e SBASHK-ut ka marrë informacione të sakta për angazhimet dhe për mendimin e SBASHK-ut për Ligjin për Këshillin

Ekonomik Social, për ndryshimet në të dhe në ligje të tjera që kanë të bëjnë me punën dhe të drejtat e të punësuarve. Koordinator i Grupit të BE-së për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me atë të

Evropës, z. Bohuslav Pokorny i ka premtuar SBASHK-ut se do të jetë i ftuar në punëtori lidhur me ndryshimet në ligjin mbi KES dhe ashtu ka ndodhur. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe përgjegjësi për financa e administratë , Ymer Ymeri


kanë bërë një prezantim të shkëlqyer të SBASHK-ut në këtë punëtori dhe kanë dhënë kontribut të lartë për ndryshimet pozitive në Ligjin për KES, ndryshime

këto që krijojnë frymë demokratike dhe mundësojnë që në KES të jetë e përfaqësuar forca reale sindikale. Për këtë angazhim përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë marrë përgëzimet e z. Pokorny dhe të ekspertës nga Holanda, znj. Skrt. Me ndryshimet e propozuara për Ligjin mbi KES krijohet mundësia që ky organ këshillues të jetë shumë efikas në shërbim të

kërkesave të të punësuarve në arsim. Këto ndryshime krijojnë mundësi shumë të mira që SBASHK-u të jetë pjesë e Këshillit Ekonomik Social dhe të përfaqësojë në mënyrën më të denjë zërin e të punësuarve në gjithë arsimin e Kosovës.

SBASHK-u vazhdon me traditën e mirë

Këtë vit në bregdetin shqiptar 420 pushues nga shkollat e Kosovës



Shtimi i vazhdueshëm i anëtarëve të SBASHK-ut ka bërë që edhe fondi për pushim e rekreacion të jetë më i fuqishëm. Kjo ka mundësuar që të shtohet numri i anëtarëve që do të

dërgohen më 20 qershor në bregdetin shqiptar për një pushim të merituar. Kujtojmë se vitin e kaluar dërguam 370 kolegë sindikalistë në pushime e këtë vit numri arriti në 420. Këshilli Drejtues dhe kryesia e SBASHK-ut kanë nisur me kohë përgatitjet dhe kanë emëruar edhe kryetarin e komisionit për përgatitjen dhe mirëvajtjen e pushimeve. Në këtë detyrë është emëruar Ymer Ymeri dhe ai tregon se kishte edhe sfida ngase nga disa komuna gati pati vonesa në përgatitjen e listave. “Se kush janë pushuesit këtë vit, si edhe herëve tjera, vendosin vetë shoqatat sindikale nëpër shkolla. Kryetarët e niveleve komunale dhe

kryetari i Sindikatës së Universitetit e dinë numrin e saktë se sa pushues do të dërgojnë dhe listat definitive e që nuk mund të ndryshohen sepse Këshilli Drejtues e ka aprovuar, do të botohen në ueb faqen tonë”, tregon Ymeri për gazetën tonë mujore elektronike “Arsimimi sot”. Ai sqaron se komisioni do të përbehet edhe nga anëtarë nga shatë regjionet dhe nga 3 të tjerë nga stafi i SBASHK-ut, por jo nga kryesia dhe këshilli Drejtues.

Komisioni i veçantë ka bërë edhe shqyrtimin e ofertave të Hoteleve e komplekseve hoteliere nga bregdeti shqiptar dhe ka vendosur se në cilin prej tyre do të vendosen të 420 pushuesit e dërguar nga SBASHK-u. Komisioni është bazuar në kushtet e akomodimit dhe në çmimin më të lirë të ofruar.

Këshilli Drejtues dhe gjithë stafi i SBASHK-ut uron që ky pushim të jetë i këndshëm dhe me plot përshtypje të mira ashtu siç ka ndodhur viteve të kaluara.